

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II. ad Cor. III. 17)

1. Rrfâna e jetës shqyptare	Fq. 65
2. Mbretnesha Helena de Francia e Kisha e Shna Prendes në Shirq	„ 75
3. Lahuta e Malcis (Te ura e Sutjeskës)	„ 91
4. Gjúha shqype në „Langues du monde, etj“ (Shkrues: Dr. H. Bariq)	„ 106
5. Prej librit të Buzukut (1555)	„ 108
6. Vallime Letrare („Hija e Maleve“)	„ 114
7. Statistika Arsimore e Shqyptaris	„ 121
8. Të ndryshme	„ 125

SHKODER

Shtypshkroja Françeskaue

1930.

Rrfâna e jetës shqyptare.

Kerkoj t' a gjêjë një mendim, një folje a një frazë me të cillen t' i bie një mend më të e njëherit, krejt e kuartë t' a shprehi pikpamjen e jetës shqyptare; në këtë kerkesë, posë s'atjera vështirsive, më tretë gjurma kahë shoh, se këtë mendim themeluer nuk mund e marrë uha prej kurrënjë theorie ditunore, prejse lenda në të cillen due me e b'at këtë hap, jeta shqyptare, nuk k'je studjue ditunisht prej k'uej, as s'k'je, më se mbahet në mend d'ër më sod, djalë shqyptari, q' h'ini në valle me s'at menduesat të botës, q' rrokull shekujve u maten me rrotullue këtë shkëm të vështirë, pikpamjen e jetës, për me dalë mbandej me caktue vlerën e randsin e sajë.

M' anësh e larg due t' i l'at për një herë theorit e filozofvet botnorë, e pa tjetër, po dal atje ke urtija shqyptare, ke ata burra të malevet, të cillët r'uejten gj'ihen, doket e shpirtin e jetës shqyptare e j'atë perfaqsesat m'at të f'jeshtët e m'at të njëmendtë për shkado të lypet mb'at jetën e popullit t' onë; këta filozof të popullit do të p'evësim, se cilli 'asht ideari i shqyptarit, e, mbas gjurmve të tyne, na menduesat do t' i perligjim vetit karakteristike të kombit, tue i naltue e tue i ndertue në systemacionin ditunuer. Njajo idé, njai parim e njajo normë, mbas së cillës shqyptari d'at të mirën e të keqen, të ndrejten e të shtrëmtën, nderen e turpin, e cilla x'ên vendin e parë në rrethin e mendimit të tij e i 'asht qanderr e drejtim për me gjykue p'ûnët, rasat e ndolljet q' u perkasin parimevet morale të pergjithta, mbas sajë edhe merr shkas për me sajue doket, mëndyrët e r'nesës e të veprimt të zakon-

